

DEKRET
Nr.7408, datë 31.7.1990

PËR MBLEDHJET, GRUMBULLIMET DHE MANIFESTIMET E SHTETASVE NË
VENDET PUBLIKE

Në mbështetje të neneve 53 e 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Shtetasit gëzojnë lirinë e grumbullimit, të mbledhjes dhe të manifestimit në vendet publike të njohur në Kushtetutë.

Neni 2

Për zhvillimin në vendet publike të mbledhjeve, të grumbulimeve ose të manifestimeve, organizatorët që mund të jenë organizata shoqërore, institucione shtetërore e parashetërorë ose individë, janë të detyruar të njoftojnë me shkrim të paktën 3 ditë përpara shefin e policisë të rrethit përkatës, kurse për raste të jashtëzakonshme 24 orë përpara.

Njoftimi duhet të përmbajë qëlimin, numrin e pjesëmarrësve, datën, orën e vendin ku do të zhvillohet veprimtaria, parullat që do të hidhen ose do të mbahen, si dhe të dhëna për identitetin e organizatorëve të saj e të personave që janë caktuar për të folur.

Quhet publike edhe një mbledhje, grumbullim ose manifestim që, edhe pse mund të jetë organizuar në formë private, për nga vendi ku do të bëhet, numri i personave që do të marrin pjesë ose për vetë qëlimin e saj, ka karakterin e një veprimtarie jopivate.

Personat që shkelin rregullat e mësipërme dënohen për kundërvajtje penale me gjoë deir në 1000 lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje lirie deri në 1 vit.

Neni 3

Shefi i ppolicisë së rrethit ka të drejtë të ndalojë zhvillimin në vendet publike të mbledhjeve, të grumbulimeve ose të manifestimeve dhe të njoftojë me shkrim organizatorët e tyre të paktën 24 orë përpara, ose për raste të jashtëzakonshme 12 orë përpara kur ato:

- a) synojnë përmbysjen e rfendit shtetëror e shoqëror;
- b) cenojnë rendin publik;
- c) nxitin kryerjen e veprave penale dhe të shkejeve të tjera të ligjit;
- ç) cënojnë ose fyejnë ndjenjën kombëtare;
- d) mund të dëmtojnë marrëdhënet me shtetet e tjera.

Neni 4

Ndalohet mbajtja e armëve të çdo lloji nga pjesëmarrësit e mbledhjeve, të grumbullimeve ose të manifestimeve që zhvillohen në vendet publike, qoftë edhe kr ato i kanë me leje. Ndalohet gjithashtu për pjesëmarrësit mbajtja e maskave.

Personat që sheklin rregullat e përcaktuara në këtë dispozitë, kur nuk kryejnë vepër penale, gjobiten në vend për kundërvajtja me 100 lekë nga shefi i policisë.

Neni 5

Ndalohen mbledhjet, grumbullimet ose manifestimet që kryhen në vende publike, kur në to bëhen thirrje rebeluese që çënojnë prestigjin dhe autoritetin e shtetit, kur vihet në rrezik sigurimi publik dhe jeta ose shëndeti i shtetasve, ose kur në to përdoren emblema, simbole e mjete të tjera figurative me përmbajtje antipopullore, fashiste e raciste që ngjallin urrejtjen kombëtare.

Neni 6

Kur mbledhja, grumbullimi ose manifestimi që organizohet nëv ende publike, zhvillohet në kundërshtim me dispozitat e këtij dekreti ose të legjislacionit në fuqi, me urdhër të shefit të policisë së rrethit vendoset shpërndarja e tyre. Për këtë pjesëmarrësve u bëhet thirrje nga punonjësit e organeve të policisë që të shpërndahen. Kur ata nuk binden, punonjësit e organeve të policisë urdhërojnë shpërndarjen e tyre me tri paralajmërime me bori (megafon), të shoqëruara me thirrje zyrtare për shpërndarje dhe, po qe se edhe pas kësa nuk binden, përdoret forca. Në rastet e parashikuara me dispozita të veçanta përdoren edhe armët.

Përdorimi i forcës bhet vetëm me urdhër të shefit të policisë ose të personit të autorizuar prej tij.

Personat që nuk i binden urdhrat për shpërndarje, dënohen për kundërvajtje penale me gjobë deri në 1000 lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje lirie deri në 1 vit.

Pjesëmarrësit që i binden urdhrat të punonjësve të organeve të policisë dhe shpërndahen, nuk dënohen për shkeljen e rregullave të parashikuara në këtë nen.

Neni 7

Punonjësit e organeve të policisë kanë të rejtë të jenë të pranishëm në mbledhjet, grumbullimet ose manifestimet që zhvillohen në vende publike dhe të kujdesen e të marrin masa për zhvillimin e tyre në përputhje me rregulat e parashikuara në këtë dekret.

Neni 8

Pjesëmarrësit, të cilët gjatë zhvillimit në vendet publike të mbledhjeve, grumbullimeve ose manifestimeve kryejnë dhe vepra të tjera penale, përgjigjen edhe sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal që parashikojnë këto vepra.

Neni 9

Pas përfundimit ose shpërndarjes së mbledhjeve, të grumbullimeve ose të manifestimeve që janë zhvilluar në vende publike, punonjësit e organeve të policisë mbajnë proces-verbal dhe detyrohen të njoftojnë organet e pushtetit në rreth.

Neni 10

Kallëzimet për kundërvajtje penale të parashikuara në këtë dekret, dërgohen për gjykim drejtpërsëdrejti në gjykatë, pasi të jenë kruer veprimet e para që parashikohet në nenin 127 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 11

Për zbatimin e këtij dekreti Ministria e Punëve të Brendshme të nxjerrë rregulloren përkatëse.

Neni 12

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI
RAMIZ ALIA